

STATUTI .
I
SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE
MEDIA 6 SH.A
KREU I – EMERTIMI – SELIA – KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1 Shoqeria MEDIA 6 SH.A [me poshte referuar si “Shoqeria”] eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe rregullohet nga ky Statut dhe nga Akti i Themelimit.
- 1.2 Shoqeria vepron ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi

Neni 2 - Emertimi dhe Selia

- 2.1 Emertimi i Shoqerise eshte MEDIA 6 SH.A
- 2.1 Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga Dervish Hima, Ada Tower, kati II.
- 2.2 Shoqeria mund te hape filiale, agjensi dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte vendit, me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.


Neni 3 – Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte 40 (dyzet) vjet duke filluar nga regjistrimi i Shoqerise ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane. Nje kohezgjatje e tille mund te zgjatet ne vijim me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

KREU II - OBJEKTI

Neni 4 – Objekti i Shoqerise

- 4.1 Objekti i Shoqerise eshte aktiviteti radioteleviziv privat. Ai perfshin prodhimin, transmetimin, dhe ritransmetimin e programeve dhe informaioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara,





shkrimi, te destinuar per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.

Aktiviteti i Shoqerise do plotesohet duke respektur paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jeten private te njeriut, si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.

- 4.3 Shoqeria mund te financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve ne perputhje me sa parashikon legjislacioni ne fuqi.
- 4.4 Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te Shoqerise dhe qellimeve te saj Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen me qellimin e mesiperm, te marre interesa jo aksionere ne Shoqeri apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene edhe qellime te tjera por qe lidhen me aktivitetin televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekoje ne favor te ndonje banke, insituti krediti dhe financiar.
- 4.5 Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638, te dates 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjin nr.8410, date 30 shtator 1998 "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republikën e Shqiperise".

KREU III – AKSIONET – KAPITALI


Neni 5 – Kapitali i Shoqerise

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte caktuar 12.000.000 [dymbedhjetemiljon] Lek i ndare ne 12.000 [dymbedhjetemije], aksione nominative dhe te regjistruara me nje vlere nominale prej 1.000 (njemije) Lek secila. Kapitali i Shoqerise formohet nga kontributet e meposhteme ne para dhe ne natyre te Ortakeve Themelues:
 - a- Z.Julien Roche, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon], Lek.
 - b- Z.Marsel Skendo, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon] Lek..
 - c- Z.Aleksander Frangaj, ka nenshkruar 4.000 (katermije) aksione, te barabarta me 4.000.000 [katermiljon] Lek.
- 5.3 Cdo aksion eshte i pandashem dhe siguron te drejten e nje vote.

J

Strojani

JK 2



5.4 Transferimi i pronësive mbi aksionet nje personi te trete, me perjashtim te rasteve te trashëgimise, i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te Aksionereve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte brenda 20 ditesh nga marrja e letres se derguar me poste rekomande ose me fax qe permban oferten e blerjes. Te gjitha njoftimet e parashikuara ne kete nen duhet t'i adresohen edhe Shoqerise.

5.5 Ne rastin e rritjes se kapitalit te Shoqerise, aksionet e reja i ofrohen Aksionereve ne proporcion me numrin e aksioneve te zoteruara prej tyre, ne baze te Nenit 155 dhe me pas te ligjit Nr. 7638, date 19 nentor 1992 "Mbi Shoqerite Tregëtare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme.

5.6 Ne rast shkatërrimi ose humbje te certifikates Drejtoria mund te leshoje certifikata te reja Drejtoria mund te percaktoje afatet dhe kushtet qe i konsideron te nevojshme dhe mund te kerkoje demshperblimet e konsideruara te pershtateshme, per te mbrojtur Shoqerine nga ndonje padi e cila mund te ngrihet kunder saj lidhur me cfaredo lloj certifikate e cila pretendohet te kete humbur ose te jete shkatërruar.

KREU IV – ASAMBLEJA E AKSIONEREVE


Neni 6 – Asambleja e Aksionereve

6.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve, e cila perbehet prej te gjithe Aksionereve te Shoqerise. Vendimet e ligjeshme te saj obligojne dhe aksioneret qe mungojne ose qe nuk kane qene dakort. Asambleja e aksionereve mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e Aksionereve mund te mblidhet ne Shqiperi dhe jashte Shqiperise. Njoftimi per thirrjen do te behet sipas percaktimit te nenit 133 te ligjit nr.7638, dt 19.nentor.1992 "Per Shoqerite Tregëtare" dhe do te tregojë vendin dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

6.2 Asambleja e Aksionereve thirret nga Kryetari i Keshillit Mkiqyres ose nga Drejtori. Ajo mund te thirret gjithashtu ne perputhje me nenin 132 te Ligjit nr 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregëtare" me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme.

6.3 Thirrja e Asamblese se Aksionereve mund te behet dhe nga Aksioneret qe perfaqesojne te pakten 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit te Shoqerise.

6.4 Asambleja e Aksionereve do te konsiderohet e thirrur ne menyren e duhur edhe nese nuk jane respektuar formalitetet qe rregullojne nje thirrje te



tille, me kusht qe ne nje Asamble te tille te marrin pjese te gjithë Aksioneret, personalisht apo te perfaqesohen me prokure, te gjithë Drejtoret dhe te gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres.



6.5 Aksioneret te cilet jane te regjistruar qe prej te pakten 5 (pese) ditesh ne regjistrin e Aksionereve dhe aksioneret te cilet depozitojne aksionet e tyre ne baze te udhezimeve dhe afateve te percaktuara ne njoftimin e thirrjes mund te marrin pjese ne Asamblene e Aksionereve.

- 6.6 Asambleja e Aksionereve ne mbledhjen e saj te pare zgjedh nga anetaret e saj Presidentin e Asamblese. Te gjitha Asamblete e aksionereve drejtohen nga Presidenti i Asamblese se Aksionereve, ose nese ky person nuk ka mundesi te marre pjese, nga nje aksioner i emeruar nga Asambleja e Aksionereve. Asambleja e Aksionereve emerone nje sekretar te Asamblese i cili nuk mund te jete dhe aksioner.
- 6.7 Aksioneret mund te zgjedhin qe te perfaqesohen ne Asamblene e Aksionereve, me nje prokure te shkruar nga nje aksioner tjetër ose nga bashkshorti/ja e tij/saj.
- 6.8 Presidenti i Asamblese se Aksionereve hap dhe drejton mbledhjen e saj. Sekretari ne fillim te cdo mbledhjeje verifikon prokurat dhe rregullshmerine e tyre, numrin e pjesemarrjesve te pranishem, nese eshte arritur quorumi i caktuar, numeron votat dhe mban procesverbalin si dhe i raporton Asamblese nese ajo eshte mbledhur ne menyre te rregullt dhe per rregullshmerine e pjesemarrjes.
- 6.9 Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet ne fund te saj nga Presidenti dhe Sekretari.

Neni 7 – Asambleja e zakonshme

- 7.1 Asambleja e zakonshme duhet te mbahet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajsh nga fundi i vitit financiar dhe vendos per :
- Percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afat mesem dhe afatgjate te Shoqerise.
 - Miratimi ose mosmiratimi i bilancit vjetor financiar te Shoqerise.
 - Kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar.
 - Miratimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve te tij.
 - Emerimi, pezullimi ose shkarkimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres si dhe caktimi I mases se shperblimit te tij.
 - Emerimi ose shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise.

- Perdorimi i fitimit neto dhe pjesen qe do ti shperndahet cdo aksioneri ne forme dividenti.

7.2 Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 date 30 shtator 1998, "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise ", dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Asambleja e Zakonshme e Aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure, te pakten 2/3 e aksioneve.

7.3 Asambleja e zakonshme merr vendimin me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 8 – Asambleja a Jashtezakonshme

8.1 Asambleja e Jashtezakonshme vendos per :

- Modifikimin ose ndryshimin ne statutin e Shoqerise.
- Zmadhim ose zvogelim te kapitalit te Shoqerise.
- Marrjen e huave nga Shoqeria, dhenien e paradhenieve nga ato, berjen e dorezanes ose te garantoje detyrimet ndaj te treteve.
- Zgjedhjen e likuidatorit.
- Zgjatjen ose shkurtimin e kohezgjatjes se veprimtarise te Shoqerise dhe per shkrirjen bashkimit, ose prishjen e Shoqerise.
- Themelimin e Shoqerive te reja ose pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera
- Shitja ose shkembimi i pasurive qe perbejne fondin, arkivor te Shoqerise.

8.2 Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 i ligjit 8410 date 30 shtator 1998, "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise ", dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure, te pakten 2/3 e kapitalit.

8.3 Ne rast se ky quorum nuk arrihet qe ne thirrjen e pare, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme, por jo me vone se 2 muaj nga data e thirrjes se Asamblese se pare.

8.4 Asambleja e jashtezakonshme e Aksionereve vendos me nje shumice te votave prej 3/4 [tre te katertat] e votave qe u perkasin aksionereve te Shoqerise te pranishem apo te perfaqesuar. Ne thirrjen e dyte vendimi merret me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

J

[Signature]

[Signature] 5

KREU 5 – ADMINISTRIMI I SHOQERISE – KESHILLI MBIKQYRES

Neni 9 – Perberja dhe Emertimi i Anetareve te Keshillit Mbikqyres

9.1 Keshilli mikqyres perbehet nga nje numer prej 3 tre antaresh.

9.2 Ne baze te Neni 105 te ligjit nr. 7638, date 19 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregetare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Anetaret e pare te Keshillit mikqyres jane :

- 1- Z. Julien Roche, qytetar francez, lindur ne Bourg En Bresse, me 1954, dhe banues ne Durres, me Pas. nr 91AE75972 (me adrese ne Shqiperi Blloku i Vilave Plazh Durres).
- 2- Z Marsel Skendaj, qytetar shqiptar, lindur ne Tepelene, me 06.11.1949 dhe banues ne Tirane, me Pas. nr 0165026 (me adrese ne Shqiperi Rr Dervish Hima , ADATower, kati 14, Tirane).
- 3- Znj. Alba Gina, qytetare shqiptare, lindur ne Lushnje, me 14.05.1975 dhe banuese ne Tirane, me Pas. nr 1262114 (me adrese ne Shqiperi Rr Dervish Hima, ADA Tower, kati 13, Tirane), e zgjedhur ne baze te nenit 109 te ligjit nr. 7698 dt. 19.nentor.1992, « Per Shoqerite Tregetare ».

9.3 Mandati i anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte 3 (tre) vjet dhe ata mund te rizgjidhen. Antaret e emeruar nga Asambleja e Aksionereve dhe ata te zgjedhur nga Punemarresi mund te revokohen per cdo arsye nga Asambleja e Aksionereve. Anetaret e zgjedhur nga punemarresit mund te revokohen edhe per rastet e parashikuara ne ligj dhe nga ky statut.

9.4 Ne rast vdekjeje, shkarkimi apo doreheqje, vendet vakant ne Keshillin Mbikqyres mund te zevendesohen brenda 3 muajsh. Anetari i Keshillit mbikqyres, i emeruar per te zevendesuar nje anetar tjetet, do te qendroje ne post per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit.

9.5 Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te marrin pjese ne me shume se 9 (nente) Keshilla Mbikqyres te tjere te shoqerive anonime , te cilat kane seline e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise.

9.6 Asambleja e Aksionereve mund te caktojte shperblim per anetaret e Keshillit Mbikqyres sic eshte parashikuar nga ligji.

Neni 10 – Kryetari dhe Zevendeskryetari I Keshillit Mbikqyres

f

Avangur

6

- 10.1 Keshilli Mbikqyres emeron nje kryetar dhe nje Zevendes kryetar nga anetaret e tij te cilet jane caktuar te therrasin mbledhjet e Keshillit dhe drejtojne diskutimet.
- 10.2 Kryetari dhe Zevendes kryetari i keshillit mund te marrin shperblim shtese, te caktuar nga Keshilli.
- 10.3 Keshilli Mbikqyres mund te emeroje here pas here nje sekretar qofte dhe jo nga anetaret e tij.
- 10.4 Ne rast mungese te Kryetarit, mbledhjet e Keshillit drejtohen nga Zevendes kryetari.


Neni 11 – Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

- 11.1 Keshilli Mbikqyres mblidhet rregullisht te pakten nje here ne tre muaj dhe sa here qe konsiderohet e nevojshme. Thirrja behet nga kryetari ose ne mungese te tij, nga Zevendes Kryetari.
- 11.2 Kryetari duhet te therrase Keshillin Mbikqyres brenda pesembedhjete ditesh nga kerkesa e motivuar prej te pakten 1/3 (nje te tretes) se anetareve te Keshillit Mbikqyres. Nese kjo kerkese mbetet pa pergjigje, kerkuesi mund te therrase mbledhjen e keshillit, duke percaktuar rendin e saj te dites.
- 11.3 Thirrja behet te pakten 3 (tre) dite para mbledhjes, me ane te nje letre rekomande, telegrami, teleksi, telefaksi ose e-mail. Thirrja mund te jete e vlefshme edhe kur eshte gojore apo pa ndonje afat kohor nese te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres do ta pranojne ate.
- 11.4 Cdo thirrje permban rendin e dites.
- 11.5 Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cfaredo vendi tjeter te treguar ne thirrje.
- 11.6 Procesverbali mbahet nga sekretari dhe nenshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres. Procesverbalet mbahen ne nje regjister te vecante.
- 11.7 Keshilli Mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme pa pranine e te pakten gjysmes se antareve te tij. Vendimet merren me shumice te



thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne raste votash te barabarta, vota e Kryetarit eshte vendimtare.

Neni 12 – Kompetencat e Keshillit Mbikqyres



- 
- 12.1 Keshilli Mbikqyres emeron dhe shkarkon Drejtorin, dhe eshte pergjegjes per mbikqyrjen e politikave dhe aktiviteteve te Shoqerise.
- 12.2 Keshilli Mbikqyres ka pergjegjesine te siguroje qe aktivitetet dhe funksionimi i shoqerise jane ne perputhje me ligjin. Ai rishikon dhe mbikqyre cdo suate aktuale apo te mundshme konflikti interesash dhe ne perputhje me ligjin, merr prej antareve te Drejtorise te gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo te mundshme te interesave qe ata mund te kene me Shoqerine si dhe kontrollon zbatimin e tyre te drejte.
- 12.3 Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje te gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet qe i quan te pershtateshme per permbushjen e te gjitha detyrave te tij.
- 12.4 Keshilli Mbikqyres i paraqet Asamblese se Aksionereve komentet e tij mbi raportin vjetor te nxjerre nga drejtoria ne perputhje me Nenin 130 te Ligjit nr. 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e nevojshme.
- 12.5 Keshilli Mbikqyres kontrollon aktivitetin e Drejtorise, miraton kriteret e marrjes ne pune, vendet e punes dhe shperblimet e punonjesve te shoqerise dhe jep autorizimin per lidhjen e te gjitha marreveshjeve qe kerkojne autorizim ne baze te Ligjit.

KREU VI – ADMINISTRIMI – DREJTORIA – KESHILLI MBIKQYRES

BORDI DREJTUES

Neni 13 – Drejtoria

- 13.1 Shoqeria drejtohet nga nje Drejtori e perbere nga nje numer prej 1 (nje) Drejtor. Drejtori mund edhe te mos jete aksioner. Drejtori nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres.



- 13.2 Drejtoret emerohen per nje afat prej 3 (tre) vitesh me te drejte rizgjedhje.
- 13.3 Drejtori eshte perfaqesues ligjor i Shoqerise. Me akt emerimi drejtor i Shoqerise eshte Z. Aleksander Frangaj.
- 13.4 Keshilli Mbikqyres cakton masen e shperblimit per Drejtorin ne momentin e emerimit te tij.
- 13.5 Drejtori mund te shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres ne cdo kohe per arsye te perligjura ne baze te ligjit. Nr.7638, dt 19.nentor.1992 » Per Shoqerine Tregetare” neni 98.
- 13.6 Ne raste se posti i drejtorit mbetet bosh per shkak vdekjeje, doreheqje, shkarkimi, paaftesi ne pune te nje prej anetareve te tij apo cdo shkaku tjeter pasardhesi qe do te plotesoje vendin do te zgjidhet nga Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e pare qe ndjek lenien bosh te vendit. Drejtori i zgjedhur ne kete menyre do te qendroje ne detyre per te gjithë kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit te tij.

Neni 14 – Mbledhja e Drejtorise

- 14.1 Drejtori therrret mbledhjen e Drejtorise, nese ajo ekziston, duke percaktuar rendin e dites , ne cdo kohe qe e quan te nevojshme apo ne rast se ai merr nje kerkese me shkrim nga te pakten 1/3 (nje e treta) e anetareve te Drejtorise. Kerkesa duhet te permbaje listen e ceshtjeve apo temave qe duhen diskutuar. Ne raste se Drejtori refuzon te therrase mbledhjen brenda 5 (pese) diteve nga marrja e kerkeses, mbledhja mund te thirret nga kerkuesit. Drejtoria do te thirret me ane te nje letre rekomande, telegrami ose telefaksi, ose e-mail te derguar te pakten 3 (tre) dite para mbledhjes. Ne raste urgjence mbledhja mund te thirret nga telegrami, telefaksi, apo e-mail te derguar nje dite para dites se caktuar te mbledhjes. Ne raste se Drejtori mungon ose per ndonje arsye nuk ka mundesi te marre pjese ne mbledhje, te gjitha funksionet e percaktuara ne kete nen i transferohen Zevendes Drejtorit, nese ka, ose Drejtorit me te vjeter ne detyre. Drejtoria do te mblidhet ne menyre te vlefshme edhe nese nuk eshte bere njoftimi formal i thirrjes, me kusht qe te gjithë Drejtoret te jene te pranishem dhe te informuar mbi rendin e dites qe do te diskutohet.
- 14.2 Mbledhjet e Drejtorise do te mbahen te pakten nje here ne tre muaj, ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter, ne Shqiperi apo jashte, dhe mund te zhvillohen edhe me telekonference ose videokonference, ose me ane te mjeteve te ngjajshme elektronike, me kusht qe te gjithë pjesemarresit te

d

Frangaj

9

identifikohen dhe tu jepet mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë aktive në to. Nëse ekzistojnë këto kushte Drejtoria quhet e mbledhur në vendin ku ndodhen Drejtori dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të mbajne procesverbalin dhe të firmosin ato.

- 14.3 Mbledhjet e Drejtorisë quhen të mbledhura në mënyrë të vlefshme kur janë të pranishëm shumica e Drejtorëve nëse ka. Vendimet e Drejtorisë janë të vlefshme kur miratohen me votën pro të shumicës së antarëve të drejtorisë të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Drejtorit është vendimtare.



Neni 15 – Kompetencat e Drejtorisë

- 15.1 Drejtori ka të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera.
- 15.2 Drejtori do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe ruajtjen e dokumentacionit financiar të duhur në përputhje me Ligjin. Drejtori duhet t'i paraqes një raport Keshillit Mbikqyres çdo tre muaj, dhe do të jetë përgjegjës për paraqitjen e bilancit vjetor, brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, me qëllim që të verifikojë dhe kontrollojë ato.

Neni 16 – Bordi Drejtues

- 16.1 Drejtoria mund të emerojë një Bord Drejtues të cilit mund t'i kerkojë mendim, i cili nuk ka fuqi detyruese mbi disa çështje të rëndësishme të vecanta në drejtimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- 16.2 Bordi Drejtues do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të zgjedhur ndërmjet personave me moral dhe prestigj të padiskutueshëm. Nuk do të ketë mospërputhje midis detyrës së anëtarit të Bordit Drejtues dhe një funksioni tjetër në Shoqëri.
- 16.3 Anëtarët e Bordit Drejtues qëndrojnë në detyrë për 2 (dy) vjet dhe mund të rizgjidhen.

KREU VII – KONTABILITETI, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR

2

Handwritten signature

Handwritten signature 10

Neni 17 – Ekspertet Kontabel

- 17.1 Kontrolli kontabel i brendshem i shoqerise kryhet nga dy eksperte kontabel te autorizuar, te emeruar per 1 (nje) vit finciar.
- 17.2 Eksperte kontabel emerohen nga Asambleja e Zakonshme.
- 17.3 Ne baze te Nenit 93 te ligjit nr. 7638, date 19 nentor 1992, "Per Shoqerite tregtare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, Eksperte kontabel te pare emerohen:
- Fahri Daria
 - Jorgji Bollano



Neni 18 – Viti Financiar – Inventari – Bilanci

- 18.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.
- 18.2 Drejtoria mban nje rregjister te rregullt te pasurise dhe te aktivitetit te tij ne perputhje me ligjin. Ne fund te vitit financiar, Drejtoria harton dhe bilancin vjetor per ate vit financiar.

Neni 19 – Rezultati i Vitit Financiar dhe Percaktimi i Fitimit.

- 19.1 Drejtoria harton bilancin vjetor ne perputhje me ligjin. 5% e fitimit neto qe rezulton nga bilanci i miratuar ne baze te dispozitave te Ligjit te mbahet per rezerven kryesore deri sa kjo rezerve te arrije 10% te kapitalit te shoqerise.
- 19.2 Fitmi i mbetur ose shperndahet ne baze te vendimeve te Asamblese se Aksionereve per shperndarjen e dividendeve apo zerave te tjere.

Neni 20 – Likujdimi dhe Mbyllja

- 20.1 Shoqeria quhet e mbyllur ne rastet e parashikuara ne Ligj. Ne rast mbyllje, Mbledhja e Jashtezakonshme e Aksionereve emerone nje apo me shume likuidatore, duke u dhene atyre kompetencat perkatese.
- 20.2 Shoqeria mund gjithashtu te shperndahet apo te bashkohet me nje tjetër me vendim te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve.

r

Handwritten signature


Handwritten signature 11

Titulli VIII – Dispozita Perfundimtare

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarveshjeve

21.1 Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin, zbatimin apo zgjidhjen e ketij Statutit dhe te Aktit te Themelimit te Shoqerise dhe, si edhe ato qe mund te lindin midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet te interesuarve.

21.2 Ne raste se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarrveshjes, ajo mund ti besohet gjykates se Rrethit Tirane.



Julien Roche

Aleksander Frangaj



Marsel Skenda

